

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 1 nga 3

Kodi: 072

KLUBI I TEKNIKËVE

Tipi i Programit: Plotësues

Historiku i Programit

Ideja për zhvillimin e këtij programi ka lindur nga vështirësitë me të cilat përballen shkollat në mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike dhe në përdorimin e tyre gjatë procesit mësimor. Nevoja për këtë program është bërë edhe më e theksuar për shkak të mungesës së përvojës së mësimdhënësve dhe hezitimit të tyre për ta integruar teknologjinë arsimore në punën e përditshme.

Ky program u mundëson pjesëmarrësve të themelojnë dhe të menaxhojnë Klubin e Teknikëve në shkollë. Funksionimi i këtij klubi do të kontribuojë në integrimin e teknologjisë arsimore në procesin mësimor dhe, rrjedhimisht, në zbatimin e Kurrikulës së Kosovës. Klubi do të kujdeset për mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike në shkollë, do t'i mbështesë mësimdhënësit në përdorimin e teknologjisë dhe në dokumentimin e punës së tyre me pajisjet arsimore, si dhe do të kontribuojë në zhvillimin e projekteve të ndryshme brenda shkollës.

Anëtarë të këtij klubi do të jenë nxënësit e klasave VI, VII, VIII dhe IX. Kompetencat që synohen të arrihen përmes këtij trajnimi bazohen në rezultatet mësimore të përcaktuara në Kurrikulën Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët në Kosovë.

Qëllimet e programit:

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit duhet të jenë gjendje të:

- Formojnë klubin e teknikëve për t'i përkrahur mësimdhënësit dhe nxënësit në përdorimin e pajisjeve të teknologjisë informative;
- Mirëmbajnë laboratorin e teknologjisë informative, si në aspektin harduerik, ashtu edhe në atë softuerik;
- Kryejnë menaxhimin bazë të rrjeteve;
- Njohin rreziqet e mundshme gjatë përdorimit të pajisjeve arsimore;
- Analizojnë përdorimin e drejtë dhe jo të drejtë të pajisjeve arsimore në shkollë;
- Përdorin udhëzime të ndryshme nga manuali për të siguruar përdorimin e duhur të pajisjeve në shkollë;
- Krijojnë njësi dhe aktivitete praktike, me fokus në integrimin e lëndëve në mes veti;
- Hartojnë planin vjetor të punës së klubit;
- Përcaktojnë rolet dhe përgjegjësitë e anëtarëve;
- Dokumentojnë aktivitetet dhe rezultatet e klubit;

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 2 nga 3

- Planifikojnë dhe realizojnë aktivitete trajnuese për nxënësit e tjerë;
- Mbështesin anëtarët e rinj të klubit;
- Bashkëpunojnë me mësimdhënës të lëndëve të ndryshme;
- Zhvillojnë aftësi të komunikimit, bashkëpunimit, lidërshipt, zgjidhjes së problemeve dhe përgjegjësisë përmes organizimit dhe funksionimit të Klubit të Teknikëve.

Përmbajtja:

Programi i trajnimit u dedikohet kryesisht mësimdhënësve të fushës kurrikulare “Jeta dhe Puna”, ndërsa përmbajtja e tij mbështet zhvillimin e kompetencave që ndërlidhen edhe me fushat e Matematikës, Shkencave të Natyrës, Gjuhëve dhe Komunikimit, Shoqërisë dhe Mjedisit, si dhe Arteve, duke reflektuar karakterin ndërkurrikular të Klubit të Teknikëve.

Programi ofron njohuri të plota dhe praktike për themelimin dhe menaxhimin e Klubeve të Teknikëve, përdorimin e kompjuterëve personalë dhe të sistemeve operative, bazat e harduerit dhe softuerit, rrjetet kompjuterike dhe pajisjet përcjellëse, si dhe bazat e dizajnit të ueb-faqeve.

Përmes këtyre moduleve, trajnimi synon të zhvillojë kapacitetet e mësimdhënësve për themelimin, koordinimin dhe mentorimin e klubeve, të cilat, përmes angazhimit të nxënësve, kontribuojnë në mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike, mbështetjen e procesit mësimor, përdorimin efektiv të teknologjisë në shkollë dhe integrimin e saj në të gjitha fushat kurrikulare.

Grupi i synuar

Programi i trajnimit u dedikohet mësimdhënësve të fushës "Jeta dhe Puna", si dhe mësimdhënësve të lëndëve që lidhen me fushat ndërkurrikulare në shkollat e mesme të ulëta, të cilët punojnë me nxënësit e klasave VI–IX. Programi synon të forcojë kapacitetet e tyre për themelimin, mentorimin dhe funksionalizimin e Klubeve të Teknikëve, si dhe për integrimin e teknologjisë në procesin mësimor. Ai shërben si trajnim plotësues në kuadër të zhvillimit profesional të mësimdhënësve.

Forma e organizimit /Kohëzgjatja

Pjesëmarrësit e përzgjedhur do të ndjekin tri ditë të plota trajnimi, me nga katër sesione 90-minutëshe në ditë, të udhëhequra nga fasilitues profesional, si dhe një ditë pune praktike në shkollë. Pas përfundimit të trajnimit, mësimdhënësit do të formojnë dhe funksionalizojnë Klubet e Teknikëve në shkollat e tyre, do të hartojnë planin e punës së klubit dhe do të realizojnë aktivitetin e parë me

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 3 nga 3

nxënësit. Gjatë kësaj periudhe, pjesëmarrësit do të mentorohen nga fasilituesit e programit, me qëllim që të mbështeten në përmbushjen e kërkesave për certifikim.

Vlerësimi/Certifikimi

Në fund të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të certifikohen duke u kredituar me gjithsej 24 orë trajnimi (6 orë x 3 ditë= 18 orë; plus 6 orë të kalkuluara për krijimin e klubeve dhe aktiviteteve në shkollë gjatë procesit të reflektimit /mentorimit).

Kriteret për certifikim janë:

- Pjesëmarrja në së paku 90% të trajnimit dhe të takimeve reflektuese me mentorin;
- Përgatitja e një portofoli që dëshmon se Klubi i Teknikëve është themeluar dhe funksionalizuar në shkollë, si dhe se ai kontribuon në mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike, mbështetjen e mësimdhënësve në përdorimin e tyre, dokumentimin e përdorimit të pajisjeve dhe zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në shkollë. Preferohet që portofoli të përgatitet në format elektronik.

Materiallet e trajnimit

- Udhëzuesi për fasilituesit e programit të trajnimit;
- Prezantimet në Power Point / Video prezantimet.